




Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	19.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4353/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.554/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.554/2023 të datës 23.03.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit/Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 19.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.554/2023 e datës 23.03.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.01/308 i datës 24.02.2023, i Komisionit Disiplinor në Komunën e Malishevës.

### A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor në Komunën e Malishevës, pas pranimit të Vendimit me numër A.nr. 1206/2022 të datës 09.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me rishqyrtimin dhe rivendosjen e rastit të ankuesit \_\_\_\_\_ me datën 24.02.2023 ka nxjerrë Vendimin Nr.01/308 sipas të cilit ankuesit në fjalë i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim të pagës prej 40% të pagës bruto, për një periudhë prej gjashtë (6) muaj". Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.01/308 të datës 24.02.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Malishevës, me datën 23.03.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokolli \_\_\_\_\_

2936/2023 të regjistruar nën shenjë A.nr.554/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve procedurale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, i njëjti po ashtu pretendon se komisioni disiplinor në mënyrë të kundërligjshme ka vepruar lidhur me shqiptimin e masës disiplinore në fjalë, kërkon që ti miratohet ankesa e parashtruar, të anulohet vendimi i komisionit në fjalë si dhe ndaj të njëjtit të bëhet kthimi i mjeteve monetare të ndalesës në pagë në masën 40% nga fillimi e deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 31.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Malishevës, ndërsa kjo e fundit me datën 24.04.2023, ka dërguar përgjigjen në ankesën e ankuesit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 04.05.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2936/2023 të regjistruar nën shenjë A.nr.554/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin të datës 23.01.2023; Vërtetimin Nr.01/1979 të datës 05.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin A.nr.1206/2022 të datës 09.02.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01/308 të datës 24.02.2023 të Komisionit Disiplinor; Ankesën e ankuesit të datës 15.12.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01/1884 të datës 16.11.2022 të Komisionit Disiplinor; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 24.04.2023 nga Komuna e Malishevës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin e ankuesit Nr.01/178 të datës 24.01.2012; Kërkesën me Nr.05/303 të datës 14.06.2022 lidhur me shqyrtimin në Komisionin Disiplinor; Vendimin me Nr.01/308 të datës 24.02.2023 të Komisionit Disiplinor; Dëshminë e hyrje daljeve në punë për ankuesin për periudhën mars-qershor të vitit 2022; Aktvendimin me Nr.01/189 të datës 21.02.2023 nga Kryetari i Komunës së Malishevës; Vendimin me Nr.01/190 të datës 21.02.2023 lidhur me formimin e komisionit disiplinor; Akt emërimin me Nr.01/60 të datës 11.01.2012 për Akt emërimin me Nr.01/321 të datës 10.03.2017 për Akt emërimin me Nr.01/1132 të datës 01.08.2018 për Vërejtjen me shkrim me Nr.05/229 të datës 10.06.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij; Vërejtjen me shkrim me Nr.05/201 të datës 30.05.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij; Vërejtjen me shkrim me Nr.05/149 të datës 29.04.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij si dhe Vendimin me numër VK/2023 të datës 27.01.2023 lidhur me shtyrjen e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Keshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës, me datën 24.02.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.01/308, sipas të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim të pagës prej 40% të pagës bruto për një periudhë gjashtë (6) muaj"*, pas Vendimit me numër A.nr.1206/2022 të datës 09.02.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ka detyruar organin e punësimit ta rishqyrtoj rastin e ankuesit pas ndërmarrjes së veprimeve lidhur me formimin e Komisionit Disiplinor dhe tek pas këtij veprimi ta rishqyrtoj procedurën disiplinore ndaj ankuesit.

Tutje, Kolegji pasi ka shqyrtuar dhe analizuar Vendimin me nr Nr.01/308 të datës 24.02.2023, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës, ka konstatuar se ky komision ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore: *"Ndalim të pagës prej 40% të pagës bruto për një periudhë gjashtë (6) muaj"*, ka marrë për bazë të gjitha faktet dhe provat që kanë shpjer deri tek ky vendim. Si rrjedhojë Kolegji pas analizimit të lëndës dhe fakteve të prezantuara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit lidhur me çeshtjen e cila është objekt i shqyrtimit të kësaj ankese, ka konstatuar se masa në fjalë e shqiptuar ndaj ankuesit ka ardhur si rezultat i mungesave në punë nga ky i fundit për periudhën kohore nga muaji mars deri në muajin qershor të vitit 2022, siq theksohet në vendimin e komisionit disiplinor se ka pasur 16 ditë mungesa në punë dhe vetëm njëra e arsyetuar për datën 10.06.2022. Lidhur me rastin në fjalë, Kolegji pas analizimit të dëshmime konkretisht evidencën elektronike të hyrje daljeve në punë nga ana e ankuesit ka konstatuar se i njëjti që nga data 23.03.2022 e deri tek data 17.06.2022 ka pasur mungesa të paarsyeshme në punë, ngase për këtë periudhë kohore i njëjti sipas këtyre dëshmime wshtw evidentuar nw sistemin e evidencës elektronike vetwm sa i pwrket hyrjes në punë ndwrsa nuk wshtw evidentuar edhe me rastin e daljes nga puna sikurse për disa nga datat në vijim: 28.03.2022, 30.03.2022, 19.04.2022, 25.04.2022, 17.05.2022 etj, po ashtu i njëjti sipas këtyre dëshmime ka pasur vetëm evidencën mbi daljen nga puna e jo edhe hyrjen në punë për disa nga datat si në vijim; 31.03.2022, 28.03.2022, 09.06.2022 etj, i njëjti gjithashtu ka pasur poashtu mungesë për ditë të plota në punë për datat 12.04.2022, 13.04.2022, 25.04.2022, 05.05.2022, 06.05.2022, 06.06.2022, 07.06.2022, 10.06.2022, 13.06.2022, 14.06.2022, 21.06.2022, 23.06.2022 deh 24.06.2022 si dhe ka pasur edhe vonesa në punë sipas evidencës për disa nga datat: 02.03.2022, 03.03.2022, 04.03.2022, 14.03.2022, 30.03.2022, 04.04.2022, 14.04.2022, 19.04.2022, 22.04.2022, 27.04.2022, 28.04.2022 29.04.2022, 11.05.2022, 16.05.2022, 20.05.2022, 01.06.2022, 02.06.2022, 09.06.2022 si dhe 30.06.2022, andaj bazuar në faktet dhe dëshmitë e prezantuara, Kolegji konstaton se ankuesi me veprimet e tij me rastin e mungesave në punë për ditët e sipërtheksuara ka bërë shkelje të rëndë disiplinore siç përcaktohet me dispozitat e nenit 46 paragrafit 3 nën paragrafit 3.5 , në të cilën thuhet se: *"3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë"*.

Po ashtu, Kolegji me qellim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar edhe dispozitat e nenit 45 të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Përgjegjësia*

disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit" si dhe nenit 50 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore" dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor, ankuesit i ka shqiptuar masën në proporcion me përgjegjësinë disiplinore dhe me rastin e shkeljes së rëndë të detyrave të punës siç përcaktohet me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku thuhet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil" ndërlidhur me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor", nga ku rrjedh se masa e tillë e shqiptuar ndaj ankuesit nga ana e Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës, është masë e shqiptuar në proporcion me shkeljen e kryer nga ankuesi në pajtim me nenin 45 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, në të cilin decidivisht thuhet se: "1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", ngase ndaj të njëjtit edhe në të kaluarën Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë i ka shqiptuar tri (3) vërejtje me shkrim për mos respektimin e orarit të punës dhe atë: Vërejtjen me Nr.05/149 të datës 29.04.2022, Vërejtjen me Nr.05/201 të datës 30.05.2022 si dhe Vërejtjen me Nr.05/229 të datës 10.06.2022, kështuqë në vlerësim të Kolegjit të Këshillit i njëjti është përgjegjës lidhur me veprimet e tij me rastin e mungesave në punë sipas fakteve dhe dëshmimeve të konstatuar në këtë vendim, prandaj edhe pretendimet ankimore të tij konform kesaj mase janë të papabazuara.

Bazuar në të lartcekurat e duke marrë parasysh të gjitha provat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret/ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprjë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit", si dhe sipas nenit 28 të këtij ligji: "Zyrtari publik gjatë



*punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”.*

Kështu që pas konstatimeve dhe vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji vlerëson se meqenëse i njëjti ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore “Ndalim të pagës prej 40% të pagës bruto për një periudhë gjashtë (6) muaj” ndaj ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike andaj edhe ka vendosur që masën e shqiptuar ta lenë në fuqi.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.554/2023, datë 19/05/2023.

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

**Arben MEHMETI**

*Arben Mehmeti*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.